



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

FLETINFORMACION

PËR ÇËSHTJEN

Numri i çështjes:
KSC-BC-2023-10

Prokurori i Specializuar kundër:



Sabit Januzit



Ismet Bahtjarit



Haxhi Shalës

Faza e çështjes:
KRYERJA E DËNIMIT

TË AKUZUARIT/AKUZAT

SABIT JANUZI

Datëlindja: 29/04/1966

- shtetas i Kosovës, i lindur në Bërvenik, Kosovë.

ISMET BAHTIJARI

Datëlindja: 27/02/1963

- shtetas i Kosovës, i lindur në Fushticë të Poshtme, Kosovë.

HAXHI SHALA

Datëlindja: 17/03/1970

- shtetas i Kosovës, i lindur në Banjë, Malishevë, Kosovë.

Përshkrimi i akuzave

Sipas Aktakuzës së Konfirmuar “dëshmitari 1” është person që i ka dhënë ose ka të ngjarë t'i japë Task Forcës Hetimore Speciale, ZPS-së dhe/ose cilitdo trupi gjykues të DHSK-së, informacion në lidhje me krime ose vepra penale të përfshira në juridiksionin e DHSK-së. Në Aktakuzë thuhet se, midis më së paku 5 prillit 2023 dhe 12 prillit 2023, Shala, Januzi dhe Bahtijari, në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe individë të tjerë, u bashkërenduan si grup para dhe pas kontakteve personale të Januzit dhe Bahtijarit me dëshmitarin 1.

Format e përgjegjësisë

Kryerje të drejtpërdrejtë/Tentativë për të kryer vepra penale
Bashkëkryerje/Marrëveshje për të kryer vepra penale
Ndihmë në kryerjen e veprave penale

Akuzat

1. Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të kërcënimit të rëndë (vepër penale kundër rendit publik)*
2. Pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi (vepër penale kundër rendit publik)
3. Frikësim gjatë procedurës penale (vepër penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike)

**Pika 1 u hoq më vonë sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, shih më poshtë.*

DËNIMET/ZHDËMTIMET

Dënimi/Zhdëmtimet, 4 shkurt 2025

Pas miratimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë të arritur midis tre të akuzuarve dhe ZPS-së, Trupi Gjykues shqiptoi dënime si vijon:

Haxhi Shala u dënua me 3 vjet burgim

Sabit Januzi u dënua me 2 vjet burgim

Ismet Bahtijari u dënua me 2 vjet burgim

Të akuzuarit u pajtuan gjithashtu që të paguajnë shumën prej gjithsej 500 euro si zhdëmtim viktimës së pranuar për pjesëmarrje në proces. Konkretisht, Shala do të paguajë 400 euro, Januzi do të paguajë 100 euro ndërsa Bahtijarit nuk i kërkohet të bëjë asnjë pagesë.

KRONOLOGJIA

Pas arrestimit nga Prokurori i Specializuar, Sabit Januzi dhe Ismet Bahtijari u transferuan në njësinë e paraburgimit të DHSK-së në Hagë më 6 tetor 2023, ndërsa Haxhi Shala u transferua më 12 dhjetor 2023.

Fillimisht ishin dy çështje gjyqësore të veçanta: njëra kundër Januzit dhe Bahtijarit (numri i çështjes KSC-BC-2023-10) dhe tjetra kundër Haxhi Shalës (KSC-BC-2023-11).

Në dhjetor 2023, ZPS-ja kërkoi bashkimin e këtyre dy çështjeve gjyqësore dhe, në shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën. Më pas, çështjes gjyqësore të bashkuar iu caktua numri KSC-BC-2023-10.

Më 4 shtator 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjykues I. Konferencat përgatitore për gjykimin u mbajtën më 7 dhe 8 tetor 2024.

Më 24 tetor 2024, Trupi Gjykues vendosi që gjykimi të fillojë më 14 nëntor të të njëjtit vit. Më 11 nëntor, ZPS-ja dhe Mbrojtja e informuan Trupin Gjykues se ishin afër arritjes së marrëveshjeve për pranimin e fajësisë për secilin të akuzuar. Më pas, më 12 nëntor 2024, me kërkesë të palëve, Trupi Gjykues e shtyu fillimin e gjykimit për të mundësuar finalizimin e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.

Gjatë seancave për pranimin e fajësisë më 18 dhe 19 dhjetor 2024, të tre të akuzuarit e pranuan fajësinë lidhur me pikat 2 dhe 3 të aktakuzës së konfirmuar.

Më 4 shkurt 2025, Trupi Gjykues miratoi marrëveshjet për pranimin e fajësisë dhe shqiptoi dënimet: Haxhi Shala u dënua me 3 vjet burgim, ndërsa Januzi dhe Bahtijari u dënuan me nga 2 vjet burgim. Të akuzuarit u pajtuan gjithashtu që të paguajnë shumën prej gjithsej 500 euro si zhdëmtim viktimës së pranuar për pjesëmarrje në proces. Konkretisht, Shala do të paguajë 400 euro, Januzi do të paguajë 100 euro ndërsa Bahtijarit nuk i kërkohet të bëjë asnjë pagesë.

Më 19 shkurt 2025, Kryetarja e DHSK-së, Ekaterina Trendafilova, vendosi modifikimin e dënimeve të Januzit dhe Bahtijarit dhe mundësoi lirimin e tyre më 21 shkurt 2025, me kushtet e përcaktuara në vendimet përkatëse. Këto kushte do të mbeten në fuqi deri në përfundim të dënimeve të dhëna nga Trupi Gjykues, domethënë për pjesën e mbetur të dënimit me dy vjet që iu shqiptua secilit prej tyre.

Januzi dhe Bahtijari përfunduan vuajtjen e dënimeve të tyre më 4 tetor 2025.

TË CAKTUAR NË KËTË ÇËSHTJE

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatëse Marzhori Masëlo

TRUPI GJYKUES I



Gjykatëse Mapi
Feld-Folia (kryesuese)



Gjykatës Roland Dekers



Gjykatës Zhilber Biti



Gjykatës Vladimir Mikula
(gjykatës rezervë)

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Taznin Shahabudin



Gjon Dëvejni

MBROJTJA (MBROJTËSIT KRYESORË)



Xhonatan Ris (për S.
Januzi)



Felisiti Geri (për I.
Bahtijari)



Tobi Kadman (për H.
Shala)

**Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj
për të skanuar kodet e mëposhtme:**




Faqja e çështjeve gjyqësore




Kalendari i gjykatës




Faqja e aktualiteteve



Kanali Youtube i DSHK-së



Profili X i DSHK-së



Profili Instagram i DSHK-së



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN